

PËRMBAJTJA

	FAQE
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	1
PASQYRAT FINANCIARE :	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHPËRFSHIRËSE	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
PASQYRA E FLUKSEVE TË PARASË	5
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE	6 – 24

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Drejtuar: Menaxhimit dhe ortakëve të Shoqërisë Alb-Building sh.p.k.

Raport mbi Pasqyrat Financiare

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkëngjitur të shoqërisë **Alb-Building sh.p.k.** (më poshtë "Shoqëria") të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2015, pasqyrën e fitim humbjes dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve të kapitaleve të veta dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin e mbyllur, si dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe informacione të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar të përmirësuara dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Përgjegjësia e Audituesit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë e kryejmë auditimin për të arritur sigurinë e arsyeshme për faktin nëse pasqyrat financiare janë pa anomali materiale.

Një auditim përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar evidencën e auditimit rreth shumave dhe informacioneve shpjeguese të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë vlerësimin e rreziqeve të anomali materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë bërjes së këtyre vlerësimeve të rrezikut, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që ka të bëjë me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të entitetit, në mënyrë që të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe të arsyeshmërisë së çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, sikurse edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë të auditimit.

Opinionit

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në të gjitha aspektet materiale, në mënyrë të drejtë, pozicionin financiar të **Alb-Building sh.p.k.** më datën 31 dhjetor 2015, performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

 MAZARS
Rr. Emin Duraku, Pall. "Binjakët",
No.5, 1000, Tiranë, Albania
phone : +355 42 27 80 15
www.mazars.al, info@mazars.al

Irena Hoxha (Pulo)
Irena Hoxha (Pulo)
Partner Angazhimi

20 prill 2016

ALB-BUILDING sh.p.k.

(Vlerat janë në Lekë)

Pasqyra e pozicionit financiar
më 31 dhjetor 2015

	Shënime	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
AKTIVET			
Aktivitet afatgjata			
Aktivitet afatgjata materiale	5	429,394,690	415,415,752
Investime të tjera afatgjata	6	479,777,831	517,244,435
Total aktiveve afatgjata		909,172,521	932,660,187
Aktivitet afatshkurtra			
Inventarë	7	22,925,896	4,584,176
Llogari të arkëtueshme tregtare	8	1,214,266,372	1,597,770,911
Llogari të arkëtueshme të tjera	9	34,033,169	31,857,345
Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	10	105,957,153	81,463,355
Mjetet monetare në arkë e në bankë	11	1,166,920,774	686,708,549
Total aktive afatshkurtra		2,544,103,364	2,402,384,336
Totali i aktiveve		3,453,275,885	3,335,044,523
KAPITALI			
Kapitali			
Kapitali i nënshkruar		800,000,000	286,500,000
Rezerva të tjera		-	-
Rezerva ligjore		29,033,891	29,033,891
Fitime të mbartura		586,859,511	811,945,458
Fitimi i ushtrimit		192,681,141	288,414,053
Total kapitali	12	1,608,574,543	1,415,893,402
DETYRIMET			
Detyrime afatgjata			
Hua afatgjata		-	-
Grante, të ardhura të shtyra e të tjera detyrime		-	-
Detyrime të tjera afatgjata		-	-
Total detyrime afatgjata		-	-
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	13	583,432,348	548,259,600
Llogari të pagueshme tregtare	14	916,147,005	944,957,271
Detyrime tatimore	15	19,967,582	18,442,146
Parapagimet e arkëtueshme	16	65,790,227	65,803,289
Grante, të ardhura të shtyra e të tjera	17	114,227,232	262,312,065
Llogari të pagueshme të tjera	18	145,136,948	79,376,750
Total detyrime afatshkurtra		1,844,701,342	1,919,151,121
Totali i detyrimeve		1,844,701,342	1,919,151,121
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		3,453,275,885	3,335,044,523


Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 24, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



ALB-BUILDING sh.p.k.*(Vlerat janë në Lekë)***Pasqyra e të ardhurave gjithpërfshirëse
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015**

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Të ardhura	19	1,048,625,979	1,685,425,657
Të ardhura të tjera	20	9,585,420	343,935
Total të ardhura		1,058,211,399	1,685,769,592
Materiale të para dhe të konsumueshme	21	(485,431,000)	(1,002,812,649)
Shpenzime personeli	22	(88,273,820)	(65,056,165)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	23	(99,454,923)	(76,415,263)
Shpenzime të tjera	24	(124,064,432)	(224,665,509)
Fitimi operativ		260,987,224	316,820,006
Të ardhurat/shpenzime financiare nga njesitë e kontrolluara	25	-	3,811,517
Shpenzime financiare (neto)	26	(33,828,962)	18,045,350
Total shpenzime financiare		(33,828,962)	21,856,867
Fitimi para tatimit		227,158,262	338,676,873
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	27	(34,477,121)	(50,262,820)
Fitimi i vitit		192,681,141	288,414,053
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për Vitin		-	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		192,681,141	288,414,053

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimat shpjeguese nga faqja 6 deri në 24, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



ALB-BUILDING sh.p.k.


(Vlerat janë në Lekë)


**Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015**

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva ligjore	Fitime të mbartura /humbje të akumuluar	Fitim (Humbje) Ushtrimit	Totali
Pozicioni financiar më 1 janar 2014	286,500,000	26,033,891	627,689,252	217,256,206	1,157,479,349
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin					-
Shpërndarje dividendi				288,414,053	288,414,053
Transferimi i fitimit		3,000,000	184,256,206	(30,000,000)	(30,000,000)
Të ardhura të tjera të përgjithshme				(187,256,206)	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2014	286,500,000	29,033,891	811,945,458	288,414,053	1,415,893,402
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin					-
Shpërndarje dividendi				192,681,141	192,681,141
Rritje kapitali	513,500,000		(225,085,947)	(288,414,053)	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2015	800,000,000	29,033,891	586,859,511	192,681,141	1,608,574,543

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 24, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shqipërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 janë aprovuar nga administratori i Alb-Building sh.p.k më 30 Mars 2016 dhe janë firmosur si më poshtë.



Znj. Doriana Dëllalisi
Hartuesi pasqyrave financiare



Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitimi i ushtrimit	192,681,141	288,414,053
<i>Axhustime për zërat jo-monetare:</i>		
Zhvlerësimi dhe amortizimi	99,454,923	76,415,263
Te ardhura nga interes	-	(18,488,224)
Shitja e Mjeteve fikseve, neto nga fitimi capital	-	(343,935)
Shpenzime për interesa	-	(442,874)
Tatimi mbi fitimin	34,477,121	50,262,820
Fitimi operativ përpara ndryshimeve ne kapitalin qarkullues	326,613,185	395,817,103
<i>Ndryshimi ne kapitalin qarkullues</i>		
Ndryshimi në inventar	(18,341,720)	4,847,057
Ndryshimi në llogari të arkëtueshme dhe të tjera	381,328,715	(657,710,988)
Ndryshimi në llogari të pagueshme dhe të tjera	38,475,368	252,748,911
Ndryshimi në parapagime e shpenzime të shtyra	(24,493,798)	-
Ndryshimi në grante dhe të ardhura të shtyra	(148,097,895)	-
Mjetet monetare te gjeneruara nga aktivitetet operative	555,483,855	(4,297,916)
Interesa të paguara	-	442,874
Tatimi mbi fitimin i paguar gjatë vitit	(34,477,121)	(50,262,820)
	(34,477,121)	(49,819,946)
Aktivitetet investuese		
Blerje e njesive të kontrolluara minus paratë e arkëtuara	37,466,604	(33,774,110)
Blerje të aktiveve afatgjata materiale	(113,433,862)	(19,347,118)
Blerje të aktiveve afatgjata jomateriale		
Të hyra nga shitja e aktiveve afatgjata material	-	1,719,670
Interesa të marra	-	18,488,224
Mjetet monetare te gjeneruara nga aktivitetet investuese	(75,967,258)	(32,913,334)
Aktivitetet financuese		
(Ripagim)/ të hyra nga hua afatshkurtër	35,172,748	70,164,009
Dividendë paguar	-	(30,000,000)
Mjetet monetare te gjeneruara nga aktivitetet financuese	35,172,748	40,164,009
Ndryshimi neto i mjeteve monetare	480,212,224	(46,867,188)
Mjetet monetare në fillim të periudhës	686,708,549	733,575,737
Mjetet monetare në fund të periudhës	1,166,920,774	686,708,549

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 24, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



1. Informacion i përgjithshëm

ALB-BUILDING sh.p.k. ("Shoqëria") është krijuar më 19.09.1994 me vendim. Veprimtaria e saj sot rregullohet sipas dispozitave përkatëse të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare" dhe nga statuti i saj.

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie është ndërtimi i veprave social- kulturore, rruge, ujesjellesa, shfrytezim, perpunim dhe tregtim i materialeve inerte si dhe prodhim e tregtim i materialeve të ndërtimit. Administratori shoqërisë është Z.Odhise Bresha.

Ortake të shoqërisë janë Z. Pellumb Beta i cili zoteron 50% të pjesmarrjes dhe Z. Odhise Bresha i cili zoteron 50% të pjesmarrjes.

Selia e shoqërisë ndodhet në Tiranë, Njesia Bashkiake nr.9, Rruga Asim Vokshi, ndertesa nr.14, hyrja 4, apartamenti 6, kodi postar 1016.


Kompania është regjistruar në Drejtorinë Rajonale të Tatim Paguesve të Mëdhenj Tiranë me NIPT J69102508C.

2. Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF)

2.1 Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale

Standardet dhe interpretimet e mëposhtme aplikohen për herë të parë për periudhat e raportimit financiar që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2015.

- SNRF 2 – qartëson përcaktimin e "Konditës së kushtëzimit" dhe bën dallimin ndërmjet 'kushtit të performancës' dhe 'kushtit të shërbimit'.
- SNRF 3 – qartëson se një detyrim për të paguar një shumë të kushtëzuar klasifikohet si detyrim financiar ose si kapital bazuar në parimet e SNK 32 (Instrumentet Financiare: Paraqitja) dhe se e gjithë shumta e kushtëzuar (detyrim financiar ose jo) matet me vlerën e drejtë në çdo datë raportimi.
- SNRF 3 – qartëson se SNRF 3 nuk gjen zbatim në kontabilizimin e lidhjeve të marrëveshjeve të përbashkëta.
- SNRF 8 – kërkon shënime shpjeguese sa i përket gjyimeve të Menaxhimit në lidhje me konsolidimin e segmenteve të aktivitetit të kompanisë dhe qartëson se për një rakordim të segmenteve të aktiveve mund të jepen shpjegime vetëm nëse segmentet e aktiveve bëhen të njohura.
- SNRF 13 konfirmon se llogaritë e arkëtueshme apo të pagueshme afatshkurtra mund të vazhdojnë të maten me vlerën e faturuar nëse impakti nga skontimi është jomaterial.
- SNRF 13 – sqaron se përjashtimet në SNRF 13 (matja e vlerës së drejtë të një grupi aktivesh dhe detyrimeve financiare mbi bazë neto) zbatohet për të gjitha kontratat brenda objektit të SNK 39 ose SNRF 9
- SNK 16 dhe SNK 38 – sqarojnë se si trajtohen vlera e mbetur dhe amortizimi i akumuluar në rastin kur një entitet kryen rivlerësim të aktiveve.
- IAS 24 – sqaron se kur një entitet merr shërbime menaxhimi nga personeli i një pale të tretë (një entitet menaxhimi), tarifat e paguara për ato shërbime duhet të pasqyrohen në shënime shpjeguese nga entiteti raportues, por jo pagesa që entiteti i menaxhimit i bën punonjësve apo drejtorëve të tij.
- IAS 40 – sqaron se SNK 40 dhe SNRF 3 nuk janë reciprokisht ekskluzive në bërjen e dallimit midis pronës së investimit dhe pronës që shfrytëzohet nga pronari dhe përcaktimin nëse blerja e një prone investimi mund të cilësohet si një kombinim biznesi.



2. Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF) (Vazhdim)

2.1 Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale (vazhdim)

Amendimi ndaj SNK 19 – “Përfitimet e punonjësve” (publikuar në nëntor 2013 dhe efektiv për periudha vjetore që fillojnë më 1 korrik 2014). Ndryshimet sqarojnë kontabilizimin për përfitimeve e punonjësve të cilat kërkojnë që punonjësit apo ndonjë palë e tretë të kontribuojnë drejt kostos së përfitimeve. Këto ndryshime lejojnë kontributet që lidhen me shërbimet, por që nuk ndryshojnë me jetëgjatësinë e shërbimit të punonjësit, (p.sh. si një % fikse ndaj pagës), të zbriten nga kosto e përfitimeve gjatë periudhës që shërbimi është ofruar. Për këtë, shumë entitete mund të vazhdojnë (por nuk janë të detyruara) të kontabilizojnë kontributet e punonjësve duke përdorur politikat e tyre aktuale të kontabilizimit.


2.2 Standardet dhe interpretimet e emetuara por ende të pa përvetësuara

Në datën e aprovimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet e mëposhtme, interpretimet dhe rishikimet janë emetuar por nuk janë ende efektive:

Deri më datë 30 prill 2015, standardet dhe interpretimet si më poshtë të publikuara nuk kanë qenë të detyrueshme për periudha raportuese që mbarojnë më 31 dhjetor 2015:

- Amendimi ndaj SNRF 9 – “Instrumentat Financiarë” (publikuar në korrik 2014 dhe efektiv për periudha vjetore që fillojnë më 1 janar 2018, por që mund të adaptohen paraprakisht për periudha financiare që fillojnë më 1 shkurt 2015).
- Amendimi ndaj SNRF 10 dhe SNK 28 – “Shitja apo kontributi i aktiveve ndërmjet një investitori dhe partnerit në një sipërmarrje të përbashkët” (publikuar në shtator 2014, dhe me datë efektive të shtyrë derin në një deklaram të dytë).
- Amendimet ndaj SNRF 10, SNRF 12 dhe SNK 28 – “Investimet në pjesëmarrje: Aplikimi i përjashtimeve të konsolidimit” (publikuar në dhjetor 2014 dhe efektiv për periudha vjetore që fillojnë më 1 janar 2016).
- Amendimi ndaj SNRF 11 – “Kontabilizimi i blerjeve të Pjesëmarrjeve në Marrëveshje të Përbashkëta” (publikuar në maj 2014 dhe efektiv për periudha vjetore që fillojnë më janar 2016).
- SNRF 14 – “Llogaritë e Shtyra për Arsye Rregullatore” (publikuar në janar 2014 dhe efektiv për periudha vjetore që fillojnë më janar 2016).
- SNRF 15 – “Të ardhurat nga Kontratat me Klientët” (publikuar në maj 2014 dhe efektiv për periudha vjetore që fillojnë më ose mbas 1 janar 2018, por që mund të adaptohen paraprakisht).
- Amendimi ndaj SNK 1 – “Iniciativë mbi Dhënie Informacionesh Shpjeguese” (publikuar në dhjetor 2014 dhe efektiv për periudha vjetore që fillojnë më ose mbas 1 janar 2016).
- Amendimi ndaj SNK 16 dhe SNK 38 – “Qartësimi i Metodave të Pranueshme të Amortizimit dhe Zhvlerësimit” (publikuar në maj 2014 dhe efektiv për periudha vjetore që fillojnë më ose mbas datës 1 janar 2016).
- Amendimet ndaj SNK 16 dhe SNK 41 – “Bujqësia: Bimët Bartëse” (publikuar në qershor 2014 dhe efektiv për periudha vjetore që fillojnë më ose mbas dates 1 janar 2016).
- Amendimi ndaj SNK 27 – “Metoda e Kapitalit në pasqyrat financiare individuale” (publikuar në gusht 2014 dhe efektiv për periudha vjetore që fillojnë më ose mbas 1 janar 2016).

Kompania ka zgjedhur të mos i përvetësojë këto standarde, rishikime dhe interpretime para datës që ato do të bëhen efektive. Kompania parashikon se përvetësimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të kompanisë në periudhën e aplikimit fillestar të tyre.



3. Bazat e përgatitjes

3.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

3.2. Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK") dhe interpretimet e nxjerra nga Komiteti për Interpretimet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("KIRFN") të BSNK-se. Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

3.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

3.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek Shqiptar ("Lek"), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

3.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

3.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

3.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.



4. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

4.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
EUR/Lek	137.28	140.14
USD/ Lek	125.79	115.23

4.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivët financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen.



4. Politikat Kontabël (vazhdim)

4.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali i nënshkruar

Kapitali i nënshkruar njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.


Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivët e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

4.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar. Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.



4. Politikat Kontabël (vazhdim)**4.4. Aktive afatgjata materiale****i. Njohja dhe matja**

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivit afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivët e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2015 dhe 2014 është si më poshtë:


Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Ndërtesa	Vlera e mbetur	5%
Makineri dhe pajisje pune	Vlera e mbetur	20%
Mjete transporti	Vlera e mbetur	20%
Pajisje zyre dhe informatike	Vlera e mbetur	25%
Mobilje dhe orëndi	Vlera e mbetur	20%

Toka nuk amortizohet.

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.



4. Politikat Kontabël (vazhdim)

4.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

4.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

4.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normal e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

Shoqëria ka vetëm qira operative.

4.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

4.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i prituri për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2015 është 15% (2014: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimin të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e perkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Shoqëria nuk ka burime diferencash të perkohshme për njohjen e tatimit të shtyrë.



4. Politikat Kontabël (vazhdim)

4.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributesh pensioni të përcaktuar.

4.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

4.12. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

4.13. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4.14. Krahasueshmëria e informacionit kontabel

Kur është e nevojshme, shifrat krahasuese axhustohen (rregullohen) në konform me ndryshimet në paraqitje në periudhën aktuale raportuese. Ndryshimet janë kryer për të paraqitur me mire natyrën e biznesit të Shoqërisë. Ato aplikohen retrospektivisht.




ALB-BUILDING sh.p.k.

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2015

(Vlerat janë në Lekë)

5. Aktivet afatgjata materiale

Me Kosto	Toka	Ndertesa	Makinieri, Pajisje dhe Mjete Transporti	Pajisje Zyre dhe Informatike	Aktive ne Proces	Totali
<i>Gjendja më 1 janar 2014</i>	86,609,338	16,169,886	987,481,237	5,277,496	8,187,500	1,103,725,457
Shtesa	-	-	18,474,608	872,510	-	19,347,118
Pakësime	-	-	(1,719,669)	-	-	(1,719,669)
Gjendja më 31 dhjetor 2014	86,609,338	16,169,886	1,004,236,176	6,150,006	8,187,500	1,121,352,906
Shtesa	-	8,187,500	109,111,466	4,322,395	(8,187,500)	113,433,861
Pakësime	-	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2015	86,609,338	24,357,386	1,113,347,642	10,472,401	-	1,234,786,767
<i>Amortizimi i akumuluar</i>						
<i>Gjendja më 1 janar 2014</i>	-	840,794	625,537,072	3,487,959	-	629,865,825
Shtesa	-	766,455	75,160,024	488,784	-	76,415,263
Pakësime	-	-	(343,934)	-	-	(343,934)
Gjendja më 31 dhjetor 2014	-	1,607,249	700,353,162	3,976,743	-	705,937,154
Shtesa	-	-	97,588,844	1,866,079	-	99,454,923
Pakësime	-	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2015	-	1,607,249	797,942,006	5,842,822	-	805,392,077
<i>Vlera kontabël neto</i>						
<i>Gjendja më 31 dhjetor 2014</i>	86,609,338	14,562,637	303,883,014	2,173,263	8,187,500	415,415,752
<i>Gjendja më 31 dhjetor 2015</i>	86,609,338	22,750,137	315,405,636	4,629,580	-	429,394,690



ALB-BUILDING sh.p.k.

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(Vlerat janë në Lek)

6. Investime te tjera afatgjata

Investimet e tjera afatgjata detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 :

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Pjesmarrje dhe financime Euro Energy	-	472,483,165
Pjesmarrje dhe financime Alb Energy	429,397,705	-
Pjesmarrje dhe financime SETA	50,380,126	44,761,270
	<u>479,777,831</u>	<u>517,244,435</u>

7. Inventari

Inventari më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 detajohet si më poshtë:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Lëndë e parë dhe materiale të tjera	22,126,696	4,584,176
Mallra	799,200	-
	<u>22,925,896</u>	<u>4,584,176</u>

8. Llogari të arkëtueshme tregtare


Balanca e llogarive të arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Klientë	1,214,266,372	1,597,770,911
	<u>1,214,266,372</u>	<u>1,597,770,911</u>

9. Llogari të arkëtueshme të tjera

Balanca e llogarive të arkëtueshme të tjera më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Paradhënie punonjësve	14,850,296	12,849,639
Marrëdhënie me doganën	155,871	513,908
Tatim mbi fitimin	18,937,002	-
Të tjera të drejta	90,000	-
Paguar detyrime tatimore të apeluara	-	18,493,798
	<u>34,033,169</u>	<u>31,857,345</u>



10. Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra të Shoqërisë më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Shpenzime të shtyra - Mali i Robit	81,463,355	81,463,355
Paguar detyrime tatimore të apeluara	18,493,798	-
Shpenzime të tjera të shtyra	6,000,000	-
	105,957,153	81,463,355

11. Mjete monetare në arkë e në bankë

Balanca e mjeteve monetare më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Mjete monetare në bankë	1,165,971,808	685,890,601
Mjete monetare në arkë	948,966	817,948
	1,166,920,774	686,708,549

12. Kapitali

Kapitali i kompanisë më 31 dhjetor 2015 është 800,000,000 Lekë i zotëruar 50% nga ortakët Pëllumb Beta dhe 50% nga ortakët Odhise Bresha.

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Numri kuotave	2	100
Vlera nominale	400,000,000	2,865,000
	800,000,000	286,500,000

Rezervat e ligjore më 31 dhjetor 2015 janë në vlerën 29,033,891 Lekë (2014: 29,033,891).


Fitime të mbartura më 31 dhjetor 2015 janë vlerën 586,859,511 Lekë (2014: 811,945,458).

Fitimi i ushtrimit më 31 dhjetor 2015 janë vlerën 192,681,141 Lekë (2014: 288,414,053).

13. Hua afatshkurtra

Huat afatshkurtra më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Marrëdhënie me shoqëri të lidhura	583,432,348	548,259,600
	583,432,348	548,259,600



14. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 detajohen si më poshtë :

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Furnitorë	916,147,005	944,957,271
	<u>916,147,005</u>	<u>944,957,271</u>

15. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore të kompanisë më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 detajohen si më poshtë :

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Detyrime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	1,949,752	1,719,045
Detyrime për tatimin mbi të ardhurat personale	285,842	128,364
Tatim fitimi	-	2,345,606
TVSH për t'u paguar	16,943,400	14,249,131
Të tjera tatime	788,588	-
	<u>19,967,582</u>	<u>18,442,146</u>

16. Parapagimet e arkëtueshme

Parapagimet e arkëtueshme më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 detajohen si më poshtë :

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Parapagime të arkëtuara-Projekti Mali i Robit	65,018,169	65,803,289
Parapagime për Ismail Qemalin	772,058	-
	<u>65,790,227</u>	<u>65,803,289</u>

17. Grante,të ardhura të shtyra e të tjera detyrime


Grante,të ardhura të shtyra e të tjera detyrime më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 detajohen si më poshtë :

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Të ardhura të shtyra	114,227,232	262,312,065
	<u>114,227,232</u>	<u>262,312,065</u>

18. Llogari të pagueshme të tjera

Llogaritë të pagueshme të tjera më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Detyrime ndaj punonjësve	66,788,963	5,421,979
Detyrime për dividend	78,347,985	73,954,771
Të tjera detyrime	145,136,948	-
	<u>145,136,948</u>	<u>79,376,750</u>



19. Të ardhura

Të ardhurat nga shitja për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 detajohen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Të ardhura nga veprimtaria e ndërtimit	1,043,936,193	1,685,425,657
Të ardhura të tjera nga veprimtaria e zakonshme	4,689,786	-
	1,048,625,979	1,685,425,657

20. Të ardhura të tjera

Të ardhurat e tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 paraqiten si më poshtë :

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Të ardhura nga komisione dhe shërbime të tjera	7,634,583	-
Të ardhura nga donacione	945,654	-
Të ardhura nga shitja e AAM	115,983	1,719,670
Vlera kontabël neto e AAM të shitura	-	(1,375,735)
Të ardhura të tjera	889,200	-
	9,585,420	343,935

21. Lëndë të para dhe materiale të konsumueshme

Shpenzimet për materialet e para dhe të konsumueshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 janë si më poshtë :

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Materiale të para dhe të tjera	441,073,176	903,894,543
Lëndë djegëse	21,447,798	81,205,120
Materiale ndihmëse	22,910,026	17,712,986
	485,431,000	1,002,812,649

22. Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 detajohen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Shpenzime për paga	75,845,952	55,928,423
Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	12,427,868	9,127,742
	88,273,820	65,056,165

ALB-BUILDING sh.p.k.

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(Vlerat janë në Lek)

23. Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi

Shpenzime amortizimi për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 detajohen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Shpenzime amortizimi	99,454,923	76,415,263
	<u>99,454,923</u>	<u>76,415,263</u>

24. Shpenzime të tjera

Shpenzime të tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 detajohen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Pjesë këmbimi e të tjera materiale	224,597	16,116,865
Blerje, energji, avull, ujë	173,385	746,423
Shërbime e punime nga të tretë	2,788,454	106,668,744
Mirëmbajtje e riparime	2,617,563	1,136,508
Siguracione	2,199,948	301,075
Shpenzime udhëtimi e dieta	87,038,473	84,579,581
Shpenzime postare dhe telekomunikimi	2,746,723	1,465,739
Shpenzime transporti	6,293,938	6,309,045
Shpenzime për shërbimet bankare	11,317,776	4,472,498
Taksa e tarifa të ndryshme	2,205,813	1,018,620
Gjoha dhe dëmshpërblime	2,128,471	220,113
Të tjera shpenzime	4,329,291	1,630,298
	<u>124,064,432</u>	<u>224,665,509</u>

25. Të ardhura nga pjesëmarrjet

Të ardhura nga pjesëmarrjet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 detajohen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Të ardhura financiare nga njësitë e kontrolluara	-	3,811,517
	<u>-</u>	<u>3,811,517</u>



ALB-BUILDING sh.p.k.

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(Vlerat janë në Lek)

26. Të ardhura / (shpenzime) financiare të tjera neto

Të ardhura /shpenzime financiare të tjera neto për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 detajohen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Të ardhura nga interest	6,879,673	18,488,224
Humbje nga këmbimet valutore	(53,529,443)	(442,874)
Të ardhura nga këmbimet valutore	12,820,808	-
	<u>(33,828,962)</u>	<u>18,045,350</u>

27. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin


Përllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Fitimi para tatimit	227,158,262	338,676,873
Shpenzime të panjohura si më poshte:	2,689,211	(3,591,404)
Gjoha dhe penalitete	2,128,471	220,113
Të tjera	560,740	-
Të ardhura nga shoqëritë e kontrolluara (të patalueshme)	-	(3,811,517)
Fitimi para tatimit	<u>229,847,473</u>	<u>335,085,469</u>
Shpenzime tatim fitimi	<u>(34,477,121)</u>	<u>(50,262,820)</u>
Fitimi Neto (pas tatimit)	192,681,141	288,414,053

28. Palët e lidhura

Balancat dhe transaksionet me palët e lidhura më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2015		31 dhjetor 2014	
	Llogaritë e pagueshme	Llogaritë e arkëtueshme	Llogaritë e pagueshme	Llogaritë e arkëtueshme
Euron Energy Group		379,680,270		553,038,800
Alb Building & Copri	487,772,269		352,244,820	
Green line	91,670,892			
	<u>579,443,161</u>	<u>379,680,270</u>	<u>352,244,820</u>	<u>553,038,800</u>



28. Palët e lidhura (vazhdim)

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Hua e arkëtueshme afatgjatë		
Euron Energy Group	-	430,411,674
Alb Energy	429,397,705	-
SETA	50,380,126	-
	<u>479,777,831</u>	<u>430,411,674</u>

Shitje ndaj paleve të lidhura

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Alb Energy	6,742,131	-
	<u>6,742,131</u>	<u>-</u>

Politika e vendosjes së çmimeve për transaksionet me palët e lidhura janë kryer me kushte tregtare dhe me çmime të përafërta me ato të tregut.

29. Manaxhimi i riskut financiar

Detyrimet financiare kryesore të Shoqërisë përbëhen nga llogaritë e pagueshme dhe të tjera detyrime. Qëllimi kryesor i këtyre detyrimeve financiare është të financojnë operacionet e Shoqërisë dhe të sigurojnë garanci për mbështetjen e operacioneve. Shoqëria ka hua dhe llogari të arkëtueshme, dhe mjete monetare dhe depozita afatshkurtra që sigurohen drejtpërdrejtë nga operacionet e saj. Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut të tregut, riskut të kreditit dhe riskut të likuiditetit.

Manaxhimi i lartë i Shoqërisë mbikqyr manaxhimin e këtyre risqeve.

Risku i tregut


Risku i tregut është risku që vlera e drejtë e flukseve monetare të ardhshme të një instrumenti financiar do të variojë për shkak të ndryshimeve në çmimet e tregut. Çmimet e tregut përfshijnë katër lloje risqesh: risku i normës së interesit, risku i kursit të këmbimit, risku i çmimit të mallrave dhe risqe të tjera të çmimeve, të tilla si risku i çmimit të kapitalit. Instrumentat financiar të prekur nga risku i tregut përfshijnë huatë, kreditë dhe depozitat.

30. Manaxhimi i riskut financiar

Risku i normave të interesit

Risku i normës së interesit përbëhet nga risku që vlera e flukseve monetare të ardhshme të një instrumenti financiar do të variojë për shkak të ndryshimeve në normat e interesit në treg dhe riskut që maturitetet e aktiveve që mbartin interes të ndryshojnë nga maturitetet e detyrimeve që mbartin interes të përdorura për të financuar ato aktive. Zgjatja kohore përgjatë të cilës norma e interesit e një instrumenti financiar është fikse, përcakton se në çfarë mase është e ekspozuar ndaj riskut të normës së interesit.

Shoqëria nuk është e ekspozuar ndaj riskut të normave të interesit për shkak se nuk ka hua nga institucionet financiare.



Risku i normave të interesit (Vazhdim)

	31 Dhjetor	
	2015	2014
Instrumenta me interest fiks		
Aktive Financiare	284,223,903	333,909,911
Detyrime Financiare		
	284,223,903	333,909,911
Instrumenta me interest variable		
Aktive Financiare	-	-
Detyrime Financiare		
	284,223,903	333,909,911

30. Manaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

Risku i kreditit

Risku i kreditit është risku që një palë tjetër nuk do të jetë në gjendje të paguajë detyrimet e saj që rrjedhin nga një instrument financiar ose marrëveshje klienti, duke çuar kështu në një humbje financiare. Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut të kreditit për shkak të aktiviteteve operacionale të saj (pikë së pari prej llogarive të arkëtueshme) dhe prej aktiviteteve të saj financuese, që përfshijnë depozitat me bankat dhe institucionet financiare, transaksionet në monedha të huaja dhe instrumenta të tjerë financiarë.


Risku i kreditit është i kufizuar në vlerën kontabël të aktiveve financiare në datën e raportimit.

	31 Dhjetor	
	2015	2014
Llogari të arkëtueshme	834,586,102	1,044,732,111
Llogari të arkëtueshme nga palet e lidhura	379,680,270	553,038,800
Llogari të tjera të arkëtueshme	34,033,169	31,857,345
Mjete Monetare	1,166,920,774	686,708,549
	2,415,220,315	2,316,336,805

Risku i Likuiditetit

Risku i likuiditetit është risku që Shoqëria mund të mos jetë në gjendje të paguajë detyrimet e saj të lidhura me detyrimet financiare në momentin e pagesës. Risku i likuiditetit është risk i qenësishëm në biznesin e Shoqërisë pasi disa aktive specifike të blera apo detyrime të shitura mund të kenë karakteristika likuiditeti që janë specifike. Nëse Shoqërisë do ti duhet të ketë shuma të mëdha në një afat të shkurtër kohor që tejkalon kërkesat normale për mjete monetare mundet që të ndeshet me vështirësi për të siguruar çmime konkurruese. Shoqëria manaxhon riskun e likuiditetit duke monitoruar në mënyrë të vazhdueshme parashikimet dhe flukset monetare aktuale dhe duke u munduar të përputhë profilet e maturitetit të aktiveve dhe detyrimeve.

	31 dhjetor 2015			
	Deri në 6 muaj	6 deri 12 muaj	1 deri 5 vjet	Total
Llogari tregtare të pagueshme dhe të tjera	363,012,766	449,447,452	268,791,317	1,081,251,535
Hua			583,432,348	583,432,348
Risku i likuiditetit me 31 dhjetor 2015	363,012,766	449,447,452	852,223,665	1,664,683,883



ALB-BUILDING sh.p.k.

Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(Vlerat janë në Lek)

Risku i likuiditetit (vazhdim)

	31 dhjetor 2014			Total
	Deri ne 6 muaj	6 deri 12 muaj	1 deri 5 vjet	
Llogari tregetare te pagueshme dhe te tjera	694,608,100	79,376,750	268,791,317	1,042,776,167
Hua			548,259,600	548,259,600
Rrisku i likuiditetit me 31 dhjetor 2014	694,608,100	79,376,750	817,050,917	1,591,035,767

Risku i monedhës

Shoqëria ndërmerr transaksione në monedhë të huaj si pasojë e ekspozimit ndaj luhatjeve të kurseve të këmbimit. Ekspozimi ndaj kurseve të këmbimit manaxhohet duke përcaktuar një politikë midis të arkëtueshmeve dhe të pagueshmeve. Vlera kontabël neto e aktiveve dhe detyrimeve monetare të shoqërisë sipas monedhave për vitin që u mbyll janë paraqitur në tabelën e mëposhtme

	31 dhjetor 2015			
	EUR	USD	LEK	Total
Llogari tregetare te arkëtueshme dhe te tjera	297,480,701		950,818,840	1,248,299,541
Mjete monetare ne arke dhe banke	520,362,723	210,950	646,347,101	1,166,920,774
Totali	817,843,424	210,950	1,597,165,941	2,415,220,315
Llogari tregetare te pagueshme dhe te tjera	69,142,300	846,483,173	165,626,062	1,081,251,535
Hua	306,904,794	-	276,527,554	583,432,348
Totali	376,047,094	846,483,173	442,153,616	1,664,683,883
Rrisku i kursit te kembimit me 31 dhjetor 2015	441,796,330	(846,272,224)	1,155,012,325	750,536,432

	31 dhjetor 2014			
	EUR	USD	LEK	Total
Llogari tregetare te arkëtueshme dhe te tjera	318,181,253		1,311,447,003	1,629,628,256
Mjete monetare ne arke dhe banke	173,148,641	14,586,119	498,973,789	686,708,549
Totali	491,329,894	14,586,119	1,810,420,792	2,316,336,805
Llogari tregetare te pagueshme dhe te tjera	115,860,278	398,552	926,517,336	1,042,776,167
Hua	320,909,275	-	227,350,325	548,259,600
Totali	436,769,553	398,552	1,153,867,661	1,591,035,767
Rrisku i kursit te kembimit me 31 dhjetor 2014	54,560,341	14,187,567	656,553,131	725,301,038



30. Vlera e drejtë e instrumentave financiare

Instrumentat financiarë përfshijnë aktivet dhe detyrimet financiare.

Aktivët financiarë përbëhen nga gjendja e llogarive në bankë dhe të arkëtueshmet. Detyrimet financiare përbëhen nga të pagueshmet.

Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare përfshihet në shumën në të cilën instrumenti mund të shkëmbëhet në një transaksion mes palëve të gatshme, dhe jo të detyrueshme të në një proces likuidimi ose shitje. Vlerat e drejta të të gjitha aktiveve financiare të shoqërisë përafrojnë vlerat e tyre kontabël kryesisht për shkak të maturimit afatshkurtër të këtyre instrumentave.

31. Burimet kryesore në vlerësimin e pasigurisë

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Një vlerësim i shumës së mbledhshme të llogarive të arkëtueshme tregtare kryhet kur arkëtimi i shumës së plotë nuk është më e mundur. Për shumat individuale të rëndësishme, ky vlerësim është kryer në baza individuale. Shumat të cilat nuk janë të rëndësishme individualisht, por që janë të vonuara, vlerësohen në mënyrë kolektive dhe aplikohet një provizion në përputhje me gjatësinë e kohës së vonuar, bazuar në normat historike të rikuperimit.

Në datën e raportimit nuk ka ndonjë tregues që llogaritë e arkëtueshme të jenë zhvlerësuar.

32. Angazhime dhe pasiguri

Çështje gjyqësore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Më 31 dhjetor 2015 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015.

Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.

33. Ngjarje pas datës së raportimit financiar

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pas datës së raportimit të cilat do të kërkonin korrigjim ose shënime në pasqyrat financiare.

